



2. Pas shkronjës “ç” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Masa e gjobës është dënim kryesor, ndërsa masa e heqjes së licencës është dënim plotësues.”.

Neni 6

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 39
Ankimi dhe ekzekutimi

1. Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.
2. Ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 7
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8010, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 52/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 138, DATË 11.5.2009 “PËR SHËNDETIN
PUBLIK”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Qëllimi dhe objekti

1. Inspektimi shëndetësor është çdo lloj forme kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, të vendosura nga legjislacioni në fuqi, për të ruajtur dhe përmirësuar shëndetin publik nga çdo subjekt, përfshirë institucione të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

2. Inspektimi shëndetësor kryhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Struktura

1. Inspektimi shëndetësor kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, sipas fushave të veprimit që përcaktohen me ligje të veçanta.

2. Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.

3. Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, për realizimin e detyrave, mbështetet teknikisht nga Instituti i Shëndetit Publik.”.

Neni 3

Në nenin 40, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Observatori Kombëtar Epidemiologjik dhe regjistrat kombëtarë të veçantë mbështeten nga Instituti i Shëndetit Publik.”.

Neni 4

Në nenin 43, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Vlerësimi i ndikimit në shëndet realizohet nga struktura rajonale e shëndetit publik.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8011, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**